



Thirrjet e hapura në  
**Digital Europe Programme**  
**(DIGITAL)**

## Thirrje të hapura në kuadër të **Digital Europe Programme**

“Digital Europe Programme” ka hapur disa thirrje për aplikim ku Shqipëria mund të aplikojë me projekte konkurruese si nga sektori publik, privat dhe akademia për një numër thirrjesh në fushën e digjitalizimit të shoqërisë dhe ekonomisë.

Digital Europe Programme përmban pesë objektiva specifike:

**Objektivi 1:** Përpunimi kompjuterik me performancë të lartë;

**Objektivi 2:** Inteligjenca artificiale, të dhënat dhe cloud;

**Objektivi 3:** Siguria kibernetike dhe besimi;

**Objektivi 4:** Aftësitë digjitale të avancuara;

**Objektivi 5:** Përhshpejtimi i përdorimit sa më të mirë të teknologjive

Programi ka hyrë në fazën e publikimit të thirrjeve specifike në një listë prej 5 projektsh ku të gjithë të interesuarit mund të gjejnë detajet, afatet, rezultatet e pritshme, objektivat dhe kriteret e tjera të procedurave.

# THIRRJET PËR APLIKIM ME AFATET PËRKATËSE PËR TË APLIKUAR

## Thirrja: 1. Alliance for Language Technologies - DIGITAL-2024-AI-B-06-LANGUAGE

Afati i aplikimit: 26 shtator 2024

### Objektivi i thirrjes është:

- Rritja e aksesit në të dhënat gjuhësore për zhvillimin dhe përshtatjen e modeleve të mëdha të bazës gjuhësore, duke marrë parasysh çështjet që lidhen me privatësinë dhe sigurinë e të dhënave, si dhe rreziqet e mundshme të dezinformimit.
- Një repozitor të familjeve të modeleve ekzistuese të bazave të mëdha gjuhësore për ripërdorim publik dhe industrial në BE.
- Një repozitor të familjeve të modeleve të mëdha të gjuhëve specifike, fushave apo industrive.
- Infrastruktura dhe shërbimet për fine-tuning të modeleve

**Kush mund të aplikojë:** minimalisht 3 aplikantë të pavarur nga 3 vende të ndryshme të pranueshme

**Shqipëria mund të aplikojë.**

KLIKO PËR MË SHUMË INFORMACION



**Buxheti: EUR 20 000 000**

**Forma e Financimit: 50% financim**

# THIRRJET PËR APLIKIM ME AFATET PËRKATËSE PËR TË APLIKUAR

**Thirrja: 2.** Towards networked Local Digital Twins in the EU -  
DIGITAL-2024-CLOUD-DATA-AI-07-DIGITALTWIN

Afati i aplikimit: 21 nëntor 2024

## Objektivi i thirrjes është:

Duke u mbështetur në hapësirën e të dhënave për "komunitetet Smart" dhe EU Local Digital Twin (LDT) Toolbox, të dyja të mbështetura nga WP 2021-2022, dhe në sinergji me veprimin "Developing CitiVerse", kjo thirrje synon të konsolidojë rezultatet ekzistuese dhe të lëvizë drejt një ekosistemi të maturuar dhe të lidhur të LDT-ve në rrjet në të gjithë BE-në për të ndihmuar qytetet dhe komunitetet të arrijnë ekonomi të shkallës kur zhvillojnë platformën e tyre të të dhënave dhe shërbimet LDT.

**Kush mund të aplikojë:** Një konsorcium me të paktën 3 aplikantë dhe që plotëson kushtet e mëposhtme: minimalisht 3 subjekte të pavarura nga 3 vende të ndryshme nga lista e vendeve që mund të aplikojnë.

## Shqipëria mund të aplikojë.

KLIKO PËR MË SHUMË INFORMACION



**Buxheti: EUR 20 000 000**

**Forma e Financimit: 100% financim**

# THIRRJET PËR APLIKIM ME AFATET PËRKATËSE PËR TË APLIKUAR

## Thirrja: 3. Support to the implementation of Multi-Country Projects (MCPs)- DIGITAL-2024-BESTUSE-07-MULTICOUNTRY

Afati i aplikimit: 21 nëntor 2024

### Objektivi i thirrjes është:

Synon të lehtësojë zbatimin e projekteve me "Multi-Country", duke përfshirë këtu ku European Digital Infrastructure Consortia (EDIC) janë zgjedhur si mekanizëm zbatimi. Projektet e përzgjedhura duhet të zbatohen ose nga një EDIC ose nëpërmjet një mekanizmi tjetër të listuar në Vendimin DDPP, duke përfshirë një konsorcium që përfshin të paktën tre Shtete Anëtare.

### Kush mund të aplikojë:

Propozimet duhet të dorëzohen nga:

- Një Konsorcium Evropian i Infrastrukturës Digjitale (EDIC)
- Një mekanizëm tjetër i implementimit të MCP i listuar në Vendimin DDPP, duke përfshirë një bashkim që përfshin të paktën tre entitete të pavarura nga tre shtete të ndryshme anëtare.

### Shqipëria mund të aplikojë.

KLIKO PËR MË SHUMË INFORMACION



**Buxheti: EUR 25 000 000**

**Forma e Financimit: 50% financim**

# THIRRJET PËR APLIKIM ME AFATET PËRKATËSE PËR TË APLIKUAR

## Thirrja: 4. EUROPEAN DIGITAL MEDIA OBSERVATORY DIGITAL-2024-BESTUSE-TECH-07-EDMO

Afati i aplikimit: 21 nëntor 2024

### Objektivi i thirrjes është:

Objektivi i kësaj thirrje është financimi i punës së qendrave të pavarura rajonale për analizën e ekosistemeve të mediave digjitale në mënyrë që të sigurohet mbulimi i zonave gjeografike të mbuluara nga qendrat EDMO për të cilat financimi përfundon në fund të vitit 2024 dhe në 2025.

### Kush mund të aplikojë:

Propozimet duhet të dorëzohen nga:

- minimalisht 2 aplikantë të pavarur;
- koordinatori i konsorciumit duhet të vendoset në një Shtet Anëtar të BE-së që do të mbulohet nga qendra.

### Shqipëria mund të aplikojë.

KLIKO PËR MË SHUMË INFORMACION



**Buxheti: EUR 8 000 000**

**Forma e Financimit: 50-70% financim**

# THIRRJET PËR APLIKIM ME AFATET PËRKATËSE PËR TË APLIKUAR

## Thirrja: 5. Specialised Education Programmes in Key Capacity Areas - DIGITAL-2024-ADVANCED-DIGITAL-07-KEYCAPACITY

Afati i aplikimit: 21 nëntor 2024

### Objektivi i thirrjes është:

Kjo thirrje synon të kontribuojë në objektivin për arritjen e 20 milionë specialistëve të TIK-ut në BE deri në vitin 2030, duke promovuar konvergjencën gjinore, siç përcaktohet në Programin e Politikave të Dekadës Digjitale. Fitimet nga përparimet kryesore në fushat teknologjike digjitale të kapaciteteve kyçe (p.sh. inteligjenca artificiale, analiza e të dhënave, virtual reality, cloud, etj) nuk mund të materializohen nëse nuk ka burime njerëzore të mjaftueshëm me njohuri të duhura për t'u zhvilluar dhe përdorur ato teknologji digjitale.

### Kush mund të aplikojë:

një bashkim i përbërë nga të paktën 6 aplikantë nga 4 vende të ndryshme të ndryshme.

### Shqipëria mund të aplikojë.

KLIKO PËR MË SHUMË INFORMACION



**Buxheti: EUR 55 000 000**

**Forma e Financimit: 50% financim**

